



Muhamedi sal-

Allahu alejhi ve selem na mësoi se “Duaja-lutja është ibadet (adhurimi)”

Tani ne sa jemi adhures të denjë të Krujuesit tonë?! Me një fjalë sa i lutemi Allahut?!

Të nderuar!

Ku janë nevojtarët?

Ku janë të shqetësuarit?

Ku janë të shtypurit?

Ku janë zemrat e pikëlluara?

Ku janë sytë e përлотur?

Ku janë dertlitë?

Ku janë ata të cilët ishin të pasur dhe mbetën të varfër?

Ku janë ata të cilët ishin të shëndoshë por i kaploi sëmundja?

Ku janë të sëmurët?

Ku janë të shtypurit?

Ku janë borxhlitë?

Vallahi, betohem në Allahun, këtë që po e them e besoj fuqimisht se dera e Allahut është e hapur për të gjithë të lartpërmendurit dhe të tjerët. Vetëm a ka kush që i lutet Allahut të Lartësuar.

I lavd-falënderuar është Allahu i cili dëgjon lutjet e lutësve.

I lavd-falënderuar është Allahu i cili dëgjon rënkimet e rënkuesve.

Allahu im! Të lutemi në çdo moment.

Allahu im! Pranoj lutjet tona.

Allahu im! Mos i humb shpresat tona.

Allahu im! Ti je afër dhe i përgjigjesh çdo njeri. Ti je ndihmëtarë i nevojtarëve. Ti je i Lartësuar që çdo njeri i cili fletë e dëgjon. Ai i cili heshtë, Ti e din fshehtësinë e tij.

Allahu im! Ti je afër dhe i përgjigjesh duave të gjynahqarëve për pendim. Ti je përgjigjur lutjeve të të gjithëve kur ata janë lutur. Lutjeve të besimtarëve dhe jobesimtarëve.

O shpirti im! O vëllezër e motra!

Kujtone Junusin alejhis-selam kur iu lut Allahut: “(Përkujto) Edhe atë të peshkut (Junusin) kur doli i hidhëruar (prej popullit) dhe mendoi se nuk do t’i vijë më puna ngushtë, po në errësira ai tha se: “Nuk ka Zot meritore për adhurim pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejt vetes!” Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuan nga tmerri. Kështu i shpëtoëmë Ne besimtarët.” (Enbija, 87-88)

Mos të habitemi, mos t’i harrojmë lutjet-duatë.

“Allahut kërkoni nga të mirat e Tij. Allahu është i dijshtëm për çdo send. ” (Enisaë, 32)

Kujto se je një rob i Allahut, nevojtarë, i varfër. Allahu është Bujarë, Mëshirues, Dhurues.

Mos harro edhe një herë se duaja-lutja është adhurim (ibadet). Shfhtëzoje në maksimum dhjetëditëshin e parë të Dhul-hixhes. Krejt në përmbyllje Muhamedi sal-Allahu alejhi ve selem na mëson:

“Nuk ka ditë në të cilat vepra e mirë është më e dashur për Allahun sesa në këtë ditë (të Dhul-hixhes). I thane: As xhihadi? Tha: As xhihadi, përveç nëse del dikush vetë dhe me pasurinë e vet dhe nuk kthehet me asgjë. (Shënon Buhariu)”

Muhamedi salallahu alejhi ve selem thotë: Nuk ka ditë që vepra te jetë më madheshtore dhe me e dashur tek Allahu sesa këto dhjete dite, prandaj shqiptoni sa më shumë tehlil (La ilahe il-Allah), tekbir (Allahu ekber) dhe tahmid (El-hamdu lil-lah). (Shënon Ahmedi)

Ulvi Fejzullahu